



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TE KOMUNES SË JUNIKUT
PËR VITIN 2025-2027

Dëgjimi i tretë buxhetor
PROCESVERBAL

Me datë 14.08.2024 duke filluar nga ora 11:00 u mbajt dëgjimi i tretë buxhetor në sallën e Kuvendit Komunal. Takimin ishte i dedikuar për të gjitha grupet e interesit ku u hap dhe moderua nga Vjollca Qestaj – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa.

Pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje Vjollca Qestaj në dëgjimin e tretë buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore me qëllim mërmbylljen e planifikimit të buxhetit për periudhën 2025-2027, fjalën ja kalon kryetarit të komunës i cili ishte prezent.

Kryetari z.Ruzhdi Shehu përshëndeti dhe falënderoj të gjithë pjesmarrësit për prezencë në dëgjimin buxhetor. Ai tregoi rëndësin e mbajtjes së këtij dëgjimi duke shprehur se këto kërkesa, sugjerime dhe ide të qytetarëve do të kontribuojnë në planifikimin sa më të mirë të buxhetit për vitet e ardhshme. Grupi punues i themeluar e ka për detyrë të analizoj të gjitha propozimet e juaja të përgatit raportin përfundimtar dhe ato të cilat kanë prioritet dhe mund të mbulohen me buxhetin e planifikuar të realizohen gjatë viteve 2025-2027. Meqenëse kishte të planifikuar paraprakisht një takim me KFOR-in për përirimin e një projekti në QKMF, ai kërkoj mirëkuptimin e pjesmarrësve për largimin e hershem dhe inkurajoi të gjithë të pranishmit të bëjnë sa më shumë sugjerime dhe të japin ide.

znj.Vjollca Qestaj tha që deri tani kemi mbajtur dy dëgjime, i pari në qershor ishte dedikuar tërësisht të gjithë qytetarët e komunës, dëgjimi i dytë u mbajt në muajin korrik vetëm me gratë e komunës dhe ky është i treti për të gjitha grupet e interesit. Po ashtu është planifikuar edhe një dëgjim i fundit gjatë muajit shtator. Në bazë të kapaciteteve buxhetore që ka Komuna e Junikut do të përgjigjet kërkesave të parashkruara nga ana juaj. Lus pjesmarrësit të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes dhe të plotësojnë listën e propozimeve për projekte kapitale, në mënyrë që ato të mbeten të dokumentuar në procesverbal dhe në raportin përfundimtar ku pastaj këto propozimet do të përcjellen tek Këshilli i Drejtorëve dhe në Kuvendin Komunal të Junikut.

Unë po vazhdoj të prezentoj shkurtimisht buxhetin dhe kapacitetet tona buxhetore që i kemi në dispozicion për vitet 2025-2027.

Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore burimet e financimit te Komunës së Junikut përfshin:

- Granti i përgjithshëm
- Grandi specifik për Arsim
- Grandi specifik për Shëndetësi
- Të hyrat Vetanake

- Donacionet

Buxheti për Komunën e Junikut parashihet të jetë në shumë prej **2,340,143.00** euro për vitin 2025.

- Grantet qeveritare: **2,135,201.00** euro
- Të Hyrat Vetanake: **204,942.00** euro

Sipas Qarkores 2025/01 Grantet qeveritare në krahasim me vitin 2024 kanë ndryshim pozitiv në vlerë prej 143,421.00 euro apo e shprehur në përqindje 7.20% .


Ndryshimi është në Grantin e përgjithshëm në vlerë prej 78,717.00 apo 7.13%, Granti specifik për Arsim në vlerë prej 34,294.00 apo 6.30%, Granti specifik për Shëndetësi në vlerë prej 30,410.00 apo 8.86% krahasuar vlerën e granteve të vitit 2024 .


Të hyrat vetanake kanë zvogëlim në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 në vlerë prej - 3,114.00 apo -1.50% .

Burimet e financimit sipas viteve në Komunën e Junikut.

	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%	Buxheti 2026	Ndryshimi	%	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
Total Buxheti	2,199,836	2,340,143	140,307	6.38	2,454,219	114,076	4.87	2,571,075	116,856	4.76
THV	208,056	204,942	(3,114)	(1.50)	222,358	17,416	8.50	240,063	17,705	7.96
Grantet Qeveritare	1,991,780	2,135,201	143,421	7.20	2,231,861	96,660	4.53	2,331,012	2,331,012	4.44
Granti i përgjithshëm	1,103,827	1,182,544	78,717	7.13	1,244,049	61,505	5.20	1,306,676	1,306,671	5.03
Granti i arsimit	544,726	579,020	34,294	6.30	596,390	17,370	3.00	614,282	614,279	3.00
Granti i shëndetësisë	343,227	373,637	30,410	8.86	391,422	17,785	4.76	410,054	410,049	4.76

Buxheti për vitin 2025 sipas burimeve të financimit







Planifikimi i shpenzimeve sipas viteve 2024 -2027

	2024	2025	2026	2027	2024/2025	2025/2026	2026/2027
Paga dhe mëditje	1,445,893.00	1,536,835	1,541,852	1,546,989	6.29	0.33	0.33
Mallra dhe shërbime	246,660.00	274,860	299,860	314,860	11.43	9.10	5.00
Shërbime komunale	38,500.00	42,950	44,950	45,950	11.56	4.66	2.22
Subvencione	62,000.00	70,000	75,000	80,000	12.90	7.14	6.67
Investimet	406,784.00	415,498	492,557	583,276	2.14	18.55	18.42
Totali i buxhetit	2,199,837.00	2,340,143.00	2,454,219.00	2,571,075.00	6.38	4.87	4.76

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Paraqitja grafike pjesëmarrja sipas kategorive ekonomike në vitin 2025



Tani fjalën ju kaloj juve nëse keni propozime për ndonjë projekt. Fjalën e mori z. Myrt Shala dhe propozoi:

- Kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen Gaxherr rruga Arif Gjoci.
- Asfaltimi i rrugës Avdyl Shala rreth 550 m.
- Ndërtimi i murit mbrojtës tek Qaush Ibishi (Gaxherr).
- Mirëmbajtja dhe eliminimi i shkurreve dhe drunjëve përgjatë rrugës në lagjen Miroci.
- Eliminimi i shtyllës elektrike tek varrezat e lagjes Miroc Malok.
- Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrugës që shpie tek Bjeshka e Pllaqicës.
- Ndërtimi i murit mbrojtës tek Llug e Begut.
- Vendosja e kamerave në lokacionin Lluga e Begut.
- Ndërtimi i pendës tek Livadhi i Verrave.

Znj.Ferdone Tofaj kërkoj qartësi më të plotë për propozimet nga ana e qytetarit Myrtë Shala duke specifikuar më detajisht emrin e rrugëve dhe gjatësinë e projekteve. Ajo theksoj që nuk është ky afati i fundit prandaj kërkoj që të marrë informacionet e duhura për këto propozime dhe ti adresoj në komunë, qoftë në dëgjimin tjetër të planifikuar apo edhe përmes linkut të publikuar në faqen e komunës.

z. Myrtë Shala tregoj që do marr informacione të detajuara pasi që këto propozime janë nga qytetarët të cilët kanë shprehur shqetësime dhe i janë drejtuar atij që ti adresoj ato në komunë.

Znj. Ferdone Tofaj shprehu shqetësim për pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve ku ky është takimi i tretë dhe interesi është shumë i ulët. Në ballafaqohemi me shumë shqetësime dhe kemi nevojë që këto të adresohen nga ana juaj dhe ti komunikohen edhe bordit të drejtorëve dhe kryetarit.

Znj. Vjollca Qestaj cekur edhe një herë që qëllimi jonë është të dëgjojmë shqetësimet e juaja dhe të marrim ide nga ju në mënyrë që ne të reflektojmë këto ide në realizim të tyre me qëllim përmirësimin e jetës për të gjithë gjatë tri viteve të ardhshme. Meqenëse këto dëgjime të mbajtura nga ana jonë monitorohen edhe nga organizata tjera ne shprehim mjaft shqetësim për pjesëmarrjen e ulët. Prandaj për të lehtësuar edhe më shumë paraqitjen e idetë të juaja ne kemi krijuar edhe një faqe të veçantë për parashtrimin e ideve dhe propozimeve të qytetarëve për

planifikim të buxhetit dhe kemi inkurajuar vazhdimisht që edhe aty të jepen propozime, mirëpo deri tani veten 4 kërkesa kemi pranuar.

Mehdi Kuqi japi propozimin:

- Ndërtimi i kanalit të ujitjes – Rruga Janik deri tek fushat Goraqe rreth 1.5 km

z. Gazmend Gjota tregoj që e ka parë linkun e publikuar në facebook për planifikim të buxhetit por nëse keni mundësi të paraqitni edhe zërat kryesorë në buxhet dhe shumën e planifikuar për secilën kategori në mënyrë që të na lehtësohet edhe neve ideja se ku mund të japim propozime marrë parasysh buxhetin që kemi në dispozicion.

znj. Vjollca Qestaj falënderoj edhe njëherë të pranishmit që morën pjesë dhe japin ide dhe e mbylli takimin.

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 24 qytetarë prej të cilëve 7 ishin të gjinisë femërore.

Përveç projekt propozimeve të cekura më lartë, qytetarët patën mundësi të shënojnë propozimet edhe në listat e shpërndara dhe ato janë:

- Asfaltimi i rrugës Avdyl Shala
- Kanali i ujitjes – Livadh i travës
- Ndërtimi i pendës Bramatok
- Kanali i ujitjes për tokat Arasha, gjatësia 1 – 1.5 km
- Asfaltimi i rrugës fushore me lokalitetin Trojet me gjatësi 60 m
- Rregullimi i rrugës fushore me lokalitetin Janik rreth lumit Erenik me gjatësi 500 m
- Kyqja në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza për shtëpitë dhe lokalet e Mulla Hysnis dhe Esat Hoxhës.

Proces mbajtëse:

Ariola Krasniqi

